

KËRKESË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE 38 KOMUNAVE TË KOSOVËS

PËR ZBATIMIN E STRATEGJIVE, LIGJEVE DHE POLITIKAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE NË KOSOVË

Tetor 2025

Sipas Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, menaxhimi i mbetjeve duhet të bazohet në funksionalizimin e hierarkisë: **Parandalim → Ripërdorim → Riciklim → Shfrytëzim energjie → Deponim i kontrolluar, monitoruar dhe sipas standardeve që mbron shëndetin e qytetarit dhe mjedisin.** Kjo qasje është në qendër të ekonomisë qarkore dhe synon të reduktojë varësinë nga burimet natyrore, të ulë ndotjen dhe të forcojë mirëqenien e qytetarëve.

Agjenda e Gjellbërt për Ballkanin Perendimor kërkon nga Kosova të harmonizojë legjislacionin dhe praktikën me standardet evropiane, të zbatojë skema të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR), të investojë në infrastrukturë për riciklim dhe të fuqizojë komunat në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme. Edhe pse Kosova ka miratuar një sërë strategjish dhe ligjesh kyçe përfshirë Strategjinë e Energjisë 2022–2031, Ligjin për Ndryshimet Klimatike dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës që pritet zbatimi mbetet shumë i ngadaltë dhe i fragmentuar për të përmbushur ambicien e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe standardet e integritimit në BE. Pa një fokus të qartë dhe përgjegjësi institucionale, agenda e qëndrueshmërisë rrezikon të ngeçë.

Mangësitë në zbatim, kapaciteti i ulët institucional dhe koordinimi i dobët ndërmënysh pengojnë progresin në të gjitha sektorët. Liberalizimi i tregut të energjisë është i paplotë, ndërsa projektet e energjisë së rinovueshme hasin vonesa për shkak të pasigurisë rregullatore dhe kapacitetit të pamjaftueshëm operacional. Politikën klimatike ekzistojnë, por zbatimi është i dobët, me burime të kufizuara dhe pa linjë të qarta përgjegjësie. Ligjet dhe strategjitë e Kosovës (Ligji për Mbeturinë 04/L-060, Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe nën-aktet përkatëse) tashmë parashikojnë parime të menaxhimit të integruar të mbetjeve, përgjegjësinë e komunave për mbledhje dhe riciklim, si dhe masa për parandalim e ndëshkim të ndotjes. Por zbatimi mbetet i kufizuar.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Në Kosovë “2021-2030” synon të rrisë përqindjen e mbetjeve komunale që trajtohen në objekte të kontrolluara (p.sh. deponi sanitare ose impiante riciklimi/biologjikë) nga 40% (2018) në 60% në vitin 2020, në 80% në vitin 2025, dhe në 100% deri në vitin 2028. Të njëjtën strategji e ka objektivin të rrisë mbulimin e kolektimit të mbetjeve komunale nga 74% e popullsisë në vitin 2018 në 80% në vitin 2021, dhe më pas në 100% deri në vitin 2028.

Kosova përballet me probleme serioze në menaxhimin e mbetjeve, të cilat pasqyrohen rregullisht në raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare. Çdo vit prodhohen rreth 480 mijë tonë mbetje komunale, nga të cilat mbi 92 për qind përfundojnë në deponi sanitare që shpesh janë të tejmbushura dhe jashtë standardeve të Bashkimit Europian. Një sfidë madhore mbetet riciklimi, pasi vetëm 2.5 për qind e mbetjeve trajtohen për t'u ripërdorur, duke e renditur Kosovën ndër vendet me performancën më të ulët në rajon. Përveç kësaj, mungesa e ndarjes së mbetjeve në burim bën që procesi i riciklimit të jetë pothuajse i pamundur, ndërsa deponitë ilegale mbeten problem i madh megjithëse numri i tyre ka rënë nga mbi 2,200 në vitin 2018 në rreth 400 në vitin 2023. Gjithashtu, në vitin 2024, të ardhurat nga taksat mjedisore arriten në vlerën 377,704,690 milionë euro dhe shpresojmë që kjo shumë të përdoret nga autoritet shtetërore për mjedisin si qëllim parësor.

Raportet theksojnë gjithashtu boshllëqet ligjore dhe institucionale: legjislacioni nuk është plotësisht i harmonizuar me acquis të BE-së, kapacitetet komunale janë të kufizuara dhe mungon mbikëqyrja efektive. Financimi i pamjaftueshëm i shërbimeve të mbetjeve ka ndikuar në mungesën e pajisjeve moderne dhe në vështirësinë për të mbuluar kostot operative.

Për pasojë, ndotja e ajrit, ujërave dhe tokës nga deponitë, si dhe rreziqet shëndetësore për komunitetet pranë tyre, janë evidente. Këto të dhëna tregojnë se menaxhimi i mbetjeve në Kosovë nuk është vetëm një çështje teknike, por një problem strukturor që kërkon reforma ligjore, investime dhe ndërgjegjësim shoqëror.

Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe 38 Komunitatet:

1. Të zbatojnë në mënyrë të menjëhershme strategjitë dhe ligjet ekzistuese për menaxhimin e mbetjeve, me plane veprimi të përditësuara dhe buxhet të garantuar;
2. Të investojnë dhe funksionalizojnë infrastrukturën për mbledhje selektive sipas standardeve dhe praktikave të suksesshme evropiane;
3. Të investojnë dhe funksionalizojnë stacione transferi dhe impiante riciklimi;
4. Të investojnë në fushata ndërgjegjësuere publike që informon dhe edukon qytetarët për dobitë që do të rezultojnë nga kontributi i tyre;
5. Të eliminojnë deponitë e paligjshme përmes kontrolleve dhe sanksioneve efektive;
6. Të publikojnë raporte vjetore mbi progresin dhe shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve;
7. Të zhvillojnë infrastrukturë moderne për ndarjen, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve, përfshirë ndarjen në burim në nivel familjar dhe biznesor;
8. Të reduktojnë dhe eliminojnë deponitë ilegale, me inspektime të rregullta dhe gjopa të qarta për ndotësit;
9. Të promovojnë partneritete publike-private për investime në sektorin e riciklimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës;
10. Të monitorojnë ndikimet mjedisore dhe shëndetësore të deponive ekzistuese dhe publikimi i të dhënave të rregullta për transparencë.
11. Të vlerësojnë deponitë të hirit për pesë apo shtatë rajonet e Kosovës, deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi i të gjitha deponive rajonale, si dhe realizimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për secilën deponi të mbetjeve urbane janë masa thelbësore për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.
12. Të subvencionojnë ekonomitë familjare, biznese apo edhe organizata që zbatojnë praktikën të ndarjeve në burim të mbetjeve organike apo të ngurta
13. Të krijojnë pilot projekteve të qëndrueshme të riciklimit si model në nivel lokal (Komunal, regjional dhe kombëtar) dhe promovimi i tyre në tërë vendin.

Ne, organizatat joqeveritare dhe qytetarë nënshkruar, jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me institucionet për të kontribuar në zgjidhje, për të monitoruar zbatimin dhe për të ngritur vetëdijen qytetare. Jemi të sigurt që nëse veprimet bashkërisht, edhe mund ta kemi një Kosovë të pastër dhe të shëndetshme ku të gjithë do të përfitojmë.

Nënshkruhet nga:

1. Balkan Forum
2. Dyvo Lab
3. Qendra e Rinise Drenas and Global Shapers Community Prishtina
4. OJQ Gjeomjedis

+383 38 728 927

info@thebalkanforum.org

thebalkanforum.org

5. Sharri Wildlife
6. Partners Kosova Center for Conflict Management (Partners K)
7. Aureola Organizata